

**INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK TIRANE**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË**  
**MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data:06.05.2019]

Për: **“NRG” sh.p.k.**  
Adresa: Rruga “Eduart Mano”, pallatet nr. 10, Kopshti Zoologjik, Selitë, Tiranë

\* \* \*

Procedura e prokurimit: ***Procedurë e Hapur - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj.***

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-11174-02-28-2019**  
Numri i referencës së LOTIT të III-të: **REF-11183-02-28-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: ***“Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane”***

- **LOTI III: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefektura Fier”**, me fond limit të planifikuar për 2 vjet në vlerë 20,733,120 (njëzet milionë e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e njëzetë) Lekë pa TVSh; Shumatorja e çmimeve njësi të shërbimeve të parashikuara për këtë lot është 60,177 (gjashtëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSh;

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]  
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme **X çmimi më i ulët**

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

**LOTI III: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefektura Fier”**

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë, Shoqëria "AIR" sh.p.k., me NIPT: L51712008C dhe Shoqëria "TRULY NOLEN" sh.p.k., me NIPT: L91519037C, të përfaqësuar nga Shoqëria "AIR" sh.p.k. dhe shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar në vlerën 33.005 (tridhjetë e tre mijë e pesë) lekë pa TVSh;
2. Shoqëria "PASTRIME SILVIO" sh.p.k., me NIPT: K91413010N dhe shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar në vlerën 46.604 (dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e katër) lekë pa TVSh.
3. Shoqëria "AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK" sh.p.k., me NIPT: L32402038K dhe shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar në vlerën 45.500 (dyzet e pesë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH;
4. Personi fizik "ALPEN PULITO", me NIPT: K61516506H, me ofertë totale 15.944.000 (pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e dyzet e katër mijë) lekë pa TVSh;
5. Personi fizik "FATOS LASHI", me NIPT: K91315005H dhe shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar në vlerën 50.405 (pesëdhjetë mijë e katërqind e pesë) lekë pa TVSH;
6. Shoqëria "NRG" sh.p.k., me NIPT: L13426006B dhe shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar në vlerën 52.610 (pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë, Shoqëria "AIR" sh.p.k., me NIPT: L51712008C dhe Shoqëria "TRULY NOLEN" sh.p.k., me NIPT: L91519037C, të përfaqësuar nga Shoqëria "AIR" sh.p.k.;
2. Shoqëria "PASTRIME SILVIO" sh.p.k., me NIPT: K91413010N;
3. Shoqëria "AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK" sh.p.k., me NIPT: L32402038K;
4. Personi fizik "ALPEN PULITO", me NIPT: K61516506H;
5. Personi fizik "FATOS LASHI", me NIPT: K91315005H.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**BOE "AIR" sh.p.k., dhe "TRULY NOLEN" sh.p.k. është SKUALIFIKUAR** për arsye se ky ofertues nuk ka paraqitur të plotë dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, konkretisht si më poshtë vijon:

1. Formulari i ofertës është paraqitur sipas shtojcës 1, është përcaktuar % e pjesëmarrjes së shërbimit (53% dhe 47%, si më sipër) në kontratën e bashkepunimit të përkohshëm me nr. 829 rep dhe nr. 148/1 kol., por BOE nuk ka përcaktuar elementët konkretë që do të kryejë secili nga anetarët e tij, kjo në kundërshtim me pikën 2, të nenit 74 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar;
2. Vërtetimi i paraqitur nga Shoqëria "AIR" sh.p.k., për përmbushjen e kriterit për xhiron mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit nuk përmbush vlerën sipas përqindjes që zotëron në marrëveshjen e bashkëpunimit;
3. Deklarata e paraqitur nga të dy Operatorët Ekonomikë të BOE, për përmbushjen e kriterit që duhet të kenë specialistë të trajnuar/certifikuar që do të kryejnë kalibrimin e paisjeve sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren, nuk përmban personin/at përgjegjës që do të kryejë/në kalibrimin e paisjeve;

**Shoqëria “PASTRIME SILVIO” sh.p.k. është SKUALIFIKUAR** për arsye se ky ofertues nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, konkretisht si më poshtë vijon:

1. Përsa i përket përmbushjes së kriterit se OE duhet të disponojë të paktën 1 (një) Aparat mjegullues me pompë me presion, të montuar në një kamionçinë për Lotin 3, rezulton se dokumentacioni i paraqitur nuk përmbush kriterin për mbi 300 litra të depozitës të pompës me presion të lartë, në kundërshtim me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

**Shoqëria “AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK” sh.p.k. është SKUALIFIKUAR** për arsye se ky ofertues nuk ka paraqitur të plotë dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, konkretisht si më poshtë vijon:

1. OE nuk ka paraqitur deklaratë dhe dëshmi dhe/ose certifikata për personin/at përgjegjës që do të kryejë/në kalibrimin e paisjeve, që vërtetojnë aftësitë teknike të tyre për kalibrimin e pajisjeve për aplikimin e produkteve të përcaktuara, duke ruajtur edhe mjedisin;
2. OE ka paraqitur të njëjtin staf teknik për kryerjen e shërbimit si në lotin e II-të, ashtu edhe në Lotin e III-të, konkretisht ka paraqitur të njëjtët aplikues, në kundërshtim me përcaktimin e Dokumentet Standarde të Tenderit, se ”Nëse OE do të ofertojë për më shumë se një lot, vetëm drejtuesi teknik do të jetë 1 (një)”;

**Subjekti “ALPEN PULITO” është SKUALIFIKUAR** për arsye se Ofertuesi nuk ka paraqitur të plotë dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, konkretisht si më poshtë vijon:

1. Formulari i ofertës nuk është paraqitur sipas formatit të kërkuar në DST nga AK. OE nuk ka ofertuar sipas shumatores së çmimeve për njësi, por sipas vlerës totale të kontratës, kjo në kundërshtim me kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe paragrafin e fundit të pikës 7.3 të udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, me nr. 6, datë 16.01.2018 *”Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”*, e ndryshuar, në të cilin citohet se *”Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për çdo artikull, apo shërbim nga Autoriteti Kontraktor”*;
2. Përsa i përket përmbushjes së kriterit se OE duhet të ketë specialistë të trajnuar/certifikuar që do të kryejnë kalibrimin e paisjeve sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren, OE ka paraqitur deklaratën në të cilën shpreh se kalibrimin do ta kryejnë punonjësit e shoqërisë ”Alba Energ” sh.p.k. dhe certifikatat e paraqitura janë lëshuar në emër të subjektit ”Alba Energ” sh.p.k., por ”ALPEN PULITO” nuk ka paraqitur asnjë marrëveshje bashkëpunimi me OE e sipërcituar përsa i përket kalibrimit të pajisjeve.
3. Përsa i përket përmbushjes së kriterit për stafin teknik, OE midis të tjerave ka paraqitur dokumentet e kërkuara edhe për 3 teknikë dezinfektimi të cilët janë të pajisur me cv, kontratë pune dhe certifikatë, por njëri prej tyre (përkatësisht z. Denis Dardha) nuk ndodhet në Listëpagesat e paraqitura nga OE, ndërkohë që kontrata e punes me z. Dardha është nënshkruar në datën 02.10.2015 dhe është me afat 10 vjeçar, deri më 02.10.2015.

”ALPEN PULITO” nuk ka ofertuar sipas shumatorës së çmimeve për njësi, por sipas vlerës totale të ofertës, kjo në kundërshtim me kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe paragrafin e fundit të pikës 7.3 të udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, me nr. 6, datë 16.01.2018 *”Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”*, e ndryshuar, në të

cilin citohet se *"Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përlogaritur për çdo artikull, apo shërbim nga Autoriteti Kontraktor"*.

**SUBJEKTI "FATOS LASHI" është SKUALIFIKUAR** për arsye se ofertuesi nuk ka paraqitur të plotë dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, konkretisht si më poshtë vijon:

1. Siguracioni i paraqitur për makinën e kërkuar është jashtë afatit të vlefshmërisë (ka skaduar më datë 23.05.2018);
2. Leja e qarkullimit dhe siguracioni janë paraqitur në gjuhën italiane dhe nuk janë shoqëruar me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, në kundërshtim me përcaktimin në Dokumentet e Tenderit ku citohet se: *"Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe"*;
3. OE nuk ka paraqitur faturën e blerjes ose deklaratën doganore të aparatit mjegullues dhe pompës me presion të lartë;
4. OE nuk ka paraqitur një deklaratë se do të përdorë ekzaktësisht të njëjtën lloj kamionçine, aparat mjegullues dhe pompë (me të cilën ka ofertuar) përgjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të shërbimit

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

**1. Shoqëria "NRG" sh.p.k. NIPT: L13426006B**

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është në vlerën 52.610 (pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *Institutit të Shëndetit Publik, me adresë Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë*, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.04.2019

Ankesa: PO

Nga BOE "AIR" sh.p.k. dhe "TRULY NOLEN" sh.p.k.

Nga OE "FATOS LASHI"

Kanë marrë përgjigje në datë 15.04.2019